

EKSPLORIMI I DIMENSIONIT KULTUROR TË INDIVIDUALIZMIT DHE
KOLEKTIVIZMIT: NJË STUDIM I DALLIMEVE GJINORE NË MESIN E NXËNËSVE TË
SHKOLLAVE TË MESME NË KOSOVË

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM
NGA
BLERINË BYTYQI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË
PRISHTINË

SHTATOR, 2023

Eksplorimi i Dimensionit Kulturor të Individualizmit dhe Kolektivizmit: Një Studim i Dallimeve
Gjinore në Mesin e Nxënësve të Shkollave të Mesme në Kosovë

Blerinë Bytyqi

Mentore: Kaltrina Kelmendi, Prof. Asoc. Dr.

Qëllimi i këtij studimi është të hulumtojë dhe kuptojë se cilat janë dallimet gjinore në dimensionin kulturor të individualizmit dhe kolektivizmit në mesin e gjimnazistëve në Kosovë dhe se a shfaqin më shumë karakteristika individualiste apo kolektiviste të rinjët kosovar. Të kuptuarit e dimensionit kulturor të nxënësve të shkollave të mesme kosovare është e rëndësishme në shqyrtimin e marrëdhënieve ndërmjet orientimit kulturor, individualizmit-kolektivizmit, dhe dallimeve gjinore. Ky hulumtim ka karakter kuantitativ, për grumbullimin e të dhënave është përdor pyetësi nga Triandis dhe Gelfland (1998), Shkalla e Individualizmit dhe Kolektivizmit (Shkalla e Orientimit Kulturor), për të analizuar vetën kolektiviste dhe individualiste. Pyetësi është administruar tek 1940 pjesëmarrës adoleshentë, në shkollat e mesme në Kosovë. Moshë e pjesëmarrësve varion nga 15 deri 18 vjeç, ndërsa gjinitë pjesëmarrëse janë 55% vajza dhe 44% djemë.

Të kuptuarit e dimensioneve kulturore të nxënësve të shkollave të mesme kosovare është një hap i parë kritik në shqyrtimin e marrëdhënieve ndërmjet orientimit kulturor, individualizmit-kolektivizmit, dhe dallimeve gjinore. Përfshirja e aspektit psikologjik në këtë studim sjell një këndvështrim të rëndësishëm për të kuptuar se si ndikojnë faktorët kulturorë në zhvillimin dhe sjelljen e individeve në fazën e adoleshencës, ku ndërthurja e ndjeshmërisë ndaj

vlerave të individualizmit dhe kolektivizmit mund të ndikojë thelbësisht në zhvillimin e tyre psikologjik.

Studimi i dimensioneve kulturore të individualizmit dhe kolektivizmit në mesin e gjimnazistëve në Kosovë është i rëndësishëm për disa arsye, ku fillimisht ndihmonë në kuptimin e asaj se si vlerat dhe besimet kulturore formojnë sjelljet dhe qëndrimet e nxënësve të shkollave të mesme ndaj vetes dhe të tjerëve. Së dyti, përmes këtij studimi njihemi me dallimet gjinore dhe se si ndërveprojnë dallimet gjinore me dimensionin kulturor të individualizmit dhe kolektivizmit. Së fundmi, studimi i dimensionit kulturor të individualizmit dhe kolektivizmit në shkollat e mesme na ndihmonë të kuptojmë dinamikat sociale në mesin e shoqërisë kosovare. Gjithashtu, studimi mund të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit ndaj kulturës dhe diversitetit në shoqërinë kosovare dhe në promovimin e vlerave të ndryshme kulturore dhe të barazisë gjinore në arsim dhe shoqëri në përgjithësi. Ky studim synon të eksplorojë dimensionet kulturore dhe dallimet gjinore. Studimi do të përpiqet t'u përgjigjet pyetjeve kërkimore dhe të testojë hipotezat si në vijim:

1. Cilit dimension kulturor i përkasin nxënësit e shkollave të mesme kosovare?
2. Cila gjini ka karakteristika individualiste dhe cila kolektiviste në mesin e nxënësve të shkollave të mesme në Kosovë?
3. Cila gjini ka karakteristika të individualizmit-kolektivizmit horizontal dhe cila karakteristika të individualizmit-kolektivizmit vertikal.

Studimi përmban katër hipoteza që do të testohen bazuar në rezultatet e analizave:

H1: Gjimnazistët kosovarë kanë karakteristika më shumë të dimensionit kulturor individualist se sa të dimensionit kulturor kolektivist.

H2: Vajzat shënojnë pikë më të larta në kolektivizm në krahasim me djemtë.

H3: Djemtë kanë karakteristika më shumë të individualizmit horizontal se sa vajzat.

H4: Vajzat kanë karakteristika më shumë të kolektivizmit vertikal se sa djemtë.

Rezultatet treguan që hipoteza e parë e hulumtimit nuk është mbështetur, ku adoleshentët shënuan më shumë pikë në konstruktin e kolektivizmit. Meqenëse të dyja vlerat e p janë të ulëta (.000), tregon se dallimet në mesataret e kolektivizmit dhe individualizmit janë statistikisht të rëndësishme. Pikët mesatare për individualizmin dhe kolektivizmin u krahasuan duke përdorur T-test. Sipas gjetjeve nga T-test, ekziston një ndryshim i rëndësishëm mes rezultateve mesatare të pjesëmarrësve në individualizëm dhe kolektivizëm. Adoleshentët duket se mbështesin vlerat kolektive më fort se vlerat individualiste mesatarisht, siç dëshmohet nga rezultati mesatar i kolektivizmit (19,75) është më i lartë se rezultati mesatar i individualizmit (18,08).

Pjesëmarrëset vajza shënuan pak më shumë pikë në kolektivizëm ($M = 19.94$), krahasuar me pjesëmarrësit djemë ($M = 19.53$). Këto rezultate mbështesin plotësisht hipotezën e dytë të hulumtimit, duke shfaqur se kolektivizmi është më i shpeshtë në mesin e vajzave. Bazuar në vlerën e p (.000), mund të konkludohet se ka një ndryshim të rëndësishëm në nivelin e kolektivizmit midis vajzave dhe djemve. Ndërsa në anën tjetër, pjesëmarrëset vajza shënuan në një mesatare prej 9.71 në shkallën e individualizmit horizontal, ndërsa pjesëmarrësit djemë shënuan 9.45. Rezultati mesatar për vajzat ($M = 9.71$) është pak më i lartë se ai për djemtë ($M = 9.45$). Të dy vajzat dhe djemtë tregojnë ndryshueshmëri në rezultatet e tyre të individualizmit horizontal, me vlerat e devijimit standart prej 1.31 dhe 1.25, respektivisht. Në të kundërtën prej asaj se çka hipoteza e tretë e studimit supozoj, djemtë treguan se nuk shfaqin më shumë karakteristika të individualizmit horizontal në krahasim me vajzat. Bazuar në vlerën e p (.000), mund të konkludohet se ka një ndryshim të rëndësishëm në nivelin e individualizmit horizontal midis vajzave dhe djemve.

Pjesëmarrëset vajza shënuan një mesatare prej 9.21 në shkallën e kolektivizmit vertikal, pak më shumë se pjesëmarrësit djemë, të cilët shënuan 9.06. Të dy grupet tregojnë ndryshueshmëri në rezultatet e tyre të kolektivizmit vertikal, me vlera të devijimit standard prej 1.51 dhe 1.05. Këto të gjetura e mbështesin hipotezën e katërt të hulumtimit, duke shfaqur se vajzat kanë më shumë karakteristika të kolektivizmit vertikal në krahasim me djemtë. Vlerat p kaq të ulëta ($p=0.015$ dhe $p=0.011$), mund të konkludojmë se ka ndryshime të signifkante statistikore në nivelin e karakteristikave të kolektivizmit vertikal midis dy grupeve gjinore. Kjo tregon se vajzat dhe djemtë kanë ndryshime të dukshme në këto karakteristika në këtë kontekst. Po ashtu, rezultatet e analizave të regresionit shfaqin ndërlidhjen signifkante mes gjinisë dhe pikëve për kolektivizëm dhe individualizëm tek adoleshentët në Kosovë. Për kolektivizmin, modeli i regresionit tregon një lidhje statistikisht signifkante ($F = 7,837$, $p = 0,005$), për individualizmin, modeli i regresionit nuk shfaq signifkancë ($F = 0.006$, $p = .937$).

Të gjeturat nga studimi nuk aprovuan hipotezen e parë, duke rezultuar se në fakt gjimnzistët shënuan më shumë pikë në kolektivizëm. Kjo e gjetur nuk mbështetet nga studimi i Kulkarni dhe kolegëve (2010), në mesin e disa kombeve, ndër ta edhe Bullgaria, si një vend gjeografikisht më afër Kosovës. Kulkarni dhe kolegët (2010), treguan se të gjeturat konstatuan për tendenca më të larta të individualizmit. Në anën tjetër të gjeturat nga studimi i Lampridis dhe Papastylianou (2017) në Greqi, treguan për nivele më të larta në kolektivizëm.

Të gjeturat se vajzat shënojnë më shumë pikë në kolektivizëm, qëndrojnë në një linjë dhe janë konsistente me të gjeturat dhe me literaturën paraprake (Zeffane, 2017; Kalnina, 2004; Arora, Singhai, & Patel, 2011; Chen, 2015; Ciochina & Faria, 2009). Shumica e vajzave shënuan më shumë në individualizmin horizontal në krahasim me djemtë, përkundër hipotezës së studimit dhe studimeve paraprake që nuk mbështesin këtë hipotezë (Dabiryan Tehrani & Yamini, 2022),

si dhe studimeve që tregojnë se djemtë shënojnë në të kundërtën më shumë në individualizëm vertikal se sa në atë horizontal (Shavitt et al., 2006). Në anën tjetër, djemtë në krahasim me vajzat shënuan më pak në kolektivizmin vertikal, duke aprovuar hipotezën e katërt, e gjetur kjo jo konsistente me të gjeturat nga literatura (Shavitt et al., 2006; Germani et al., 2010).

Studimi gjeti se nxënësit e shkollave të mesme kanë një orientim kulturor kolektivist. Kjo gjetje thelbësore përcjell domosdoshmërinë për qëndrim të ndjeshëm dhe të nuancuar nga ana kulturore për këshilluesit dhe psikologët e shkollave gjatë ofrimit të shërbimeve këshillimore. Duhet të kuptohet se si sfondi kulturor ndikon në besimet, perceptimet, dhe qëllimet e nxënësve dhe të përshtaten strategjitë e ofrimit të shërbimeve me vlerat dhe besimet e tyre. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që edhe vetë këshilluesit dhe psikologët të reflektojnë mbi prirjet e tyre kulturore personale, sepse kjo ndikon në qasjen dhe stilin terapeutik. Politikbërësit, këshilluesit, dhe psikologët duhet të marrin parasysh këto faktorë kur dizajnojnë intervenimet në shkolla, veçanërisht në vendet me orientim kolektivist, ku duhet të promovohet bashkëpunimi dhe mbështetja e marrëdhënieve pozitive për të adresuar çështjet si bullizmi në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kulturore.